



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 301 Prot.

Berat, më 15.01, 2026

V E N D I M

Nr. 33 datë 15.01, 2026

PËR

MIRATIM TË PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108, datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil”, vendimit nr.832 date 05.12.2025 “Për miratimin e Strukturës, Organogramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, për vitin 2026 si edhe informacionin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil, Kryetari i Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Numri i pozicioneve vakante të punës në shërbimin civil , në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2026 do të jetë 16(**gjashtëmbëdhjetë**) gjithsej sipas kategorive të mëposhtme :

a)Për kategorinë ekzekutive 6(gjashtë) pozicione vakante

- Specialist i vlerësimit të taksave dhe tarifave për ambulantët, institucionet në , Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave.
- Specialist për Taksat dhe Tarifatat në Njësinë Administrative Velabisht, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
- Specialist Jurist, Drejtoria Juridike
- Specialist i Emergjencave Civile në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit .
- Specialist i Parandalimit dhe Mbulimit të Terrenit në Sektorin e Mbrojtjes Civile në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit
- Specialist i Protokollit dhe Ceremonialit zyrtar, Sektori I Aktiviteteve dhe Median Sociale në Drejtorinë e Turizmit dhe Aktiviteteve
- Specialist i Protokollit dhe Ceremonialit zyrtar, Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve

b.)Për kategorinë e Ulët Drejtuese 7(shtatë) pozicione vakante:

- Përgjegjës i sektorit të Auditit, Sektori I Auditit të Brendshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

- Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zbatimit të Buxhetit në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit
- Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit , Menaxhimit Financiar & Kontrollit në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit
- Përgjegjës I Sektorit të Emergjencave Civile në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit
- Përgjegjës i Sektorit për Administrimin e Sistemit Elektronik të Lejeve në Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.
- Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Pagesave të Aftesisë së kufizuar në Drejtorinë e Shërbimit Social
- Përgjegjës i Sektorit për Turizmin, Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve.

c) Për kategorinë e Mesme Drejtuese 3(tre) pozicione vakante:.

- Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave.
- Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve
- Drejtor i Turizmit dhe Aktiviteteve

2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , në cilësinë e Njësisë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore..

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
Ervin Ceca

